

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 dhe 3 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06...198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19), neni 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 14.07.2023, miratoi këtë:

## **Q Ë N D R I M P A R I M O R**

**Leja që është dhënë nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për incizimin apo fotografimin e një lënde konkrete është me vlefshmëri nga dita e lejes së dhënë deri në përfundimin e shqyrtimit të lëndës.**

## **A r s y e t i m**

Në zbatimin e nenit 360 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë penale, dhe në lidhje me nenin 105 paragrafi (1) nga Rregullorja gjyqësore, kryetari, respektivisht UD Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dukshëm nga disa aktvendime të miratuara ndryshe është vepruar në procedurën gjatë vendimmarrjes së kërkesave të parashtruara për incizim dhe fotografim të seancës së një lënde konkrete, e gjithë kjo si rezultat i përmbajtjes së vet kërkesës për ndjekjen, incizimin dhe fotografimin.

Ndjekja e seancës të një lënde konkrete nuk është çështje, për të cilën duhet të jepet leje nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht nga Kryetari i gjykatës për shkak që një gjë e tillë nuk përfshihet në nenin 360 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë penale, përkatësisht neni 105 nga Rregullorja gjyqësore, por paraqet rrethanë nga sfera e udhëheqjes me seancën e lëndës nga Kryetari i Këshillit që e udhëheq seancën, rregulla të cilat përfshihen në të gjitha ligjet proceduese dhe është me natyrë juridike për të cilat duhet të kujdeset Kryetari i Këshillit, duke respektuar parimet themelore për publikun dhe transparencën për çdo procedurë.

I dukshëm është edhe veprimi i ndryshëm në lidhje me çështjen për vlefshmërinë e lejes së dhënë për incizimin dhe fotografimin që e imponon nevojën për miratimin e Qëndrimit parimor, që e përfshin edhe këtë çështje, me të cilën do të mundësohet që parashtruesit e kërkesës në situatën e shtyrjes apo ndërprerjes e seancës të mos parashtrjnë kërkesë të këtillë përsëri.

Sipas nenit 102 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, seanca në gjykatat dhe kumtimi i aktgjykimit janë publike. Publiku mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj.

Sipas nenit 353, paragrafi (1) të Ligjit për procedurë penale, seanca kryesore është publike.

Sipas nenit 105 paragrafi (1) nga Rregullorja gjyqësore, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht kryetari i gjykatës në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim jep leje për incizimin apo fotografimin e një lënde konkrete.

Sipas nenit 360 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë penale, në gjykatë nuk mund të kryhen incizime filmike dhe televizive. Me përjashtim, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të lejojë incizim të atillë të shqyrtimit të veçantë kryesor. Nëse incizimi është lejuar, këshilli i seancës kryesore mundet për shkaqe të arsyeshme të vendos që pjesë të veçanta të seancës kryesore të mos incizohen.

Nga përmbajtja e dispozitave të theksuara ligjore pa diskutim buron se Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht, Kryetari i gjykatës janë të autorizuar të vendosin mbi kërkesën e parashtruar me shkrim për incizim apo fotografim për një lëndë konkrete.

Në nenin 106, paragrafi (1) nga Rregullorja gjyqësore përcaktohet se gjatë vendimmarrjes për dhënien e lejes për incizim dhe fotografim bëhet kujdes për interesin dhe besimin e publikut.

Sipas nenit 6 nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut aktgjykimi kumtohet publikisht, ndërsa neni 10 e garanton lirinë e pranimit dhe bartjen e informacioneve.

Parimi i transparencës së seancës kryesore, përkatësisht se kush mund të marrin pjesë në seancën kryesore është përcaktuar me nenin 102 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht me nenin 353 të Ligjit për procedurë penale.

Nga këtu, në kuptim të nenit 105 paragrafi (1) nga Rregullorja gjyqësore dhe nenin 360 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë penale, lejet e dhëna kanë të bëjnë vetëm për incizim dhe fotografim, por jo edhe për ndjekjen e seancës apo, vetëm për incizimin dhe fotografimin në apo jashtë ndërtesës gjyqësore.

**GJYKATA SUPREME E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
SEANCA E PËRGJITHSHME**